

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Programi Qeverisës 2021-2025; ¹ .
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	31.05.2024 – 28.06.2024
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	9.7.2024
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 10.5.2024
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2024 – MShSKB - Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Martin Kajo Martin.kajo@sipermarrja.gov.al 0693941293

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemet kryesore konsistojnë në vështirësi në aplikimin e ligjit 10433/2011, të lidhura kryesisht me arsye strukturore. Ligji nuk mundëson një dialog institucional të rregullt midis Inspektoratit Qendror me inspektoratet e tjera dhe ministritë respektive. Vështirësitë kryesore lidhen me mbivendosjet e funksioneve, me diskutimet për përmirësimin e sistemit elektronik, diskutimet e vendosjet e sistemeve të riskut në inspektorate specifike, organizimet e trajnimeve, etj.

Aktualisht, mbikëqyrja e inspektimeve në Shqipëri është përqendruar te Inspektorati Qendror, i cili nuk ka arritur të zhvillojë plotësisht autoritetin rregullator të nevojshëm. Si pasojë, inspektoratet janë të përballura me sfida si profesionalizmi i ulët, konflikte administrative, dhe infrastrukturë jo e përshtatshme. Sistemi aktual përfshin gjithashtu praktika të nepotizmit dhe mungesë të një rrugëtimi të qartë karriere për inspektorët.

Problematikat në Inspektoratet Shtetërore kanë ndikuar në ushtrim të kompetencave administrative, inspektuese në subjekt në paligjshmëri, në formë permanente dhe duke u bërë për Operatorët e Biznesit, barrë administrative dhe hallkë korruptive gjatë inspektimeve të të gjitha fushave, në Republikën e Shqipërisë.

¹ https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf;

<http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/07/30/466>

Për të adresuar këto probleme, është thelbësore të forcohet kuadri ligjor, në mënyrë që të sigurojë zbatimin më të mirë të ligjit për inspektimin, të eliminojë mbivendosjen e kompetencave, të ulë barrën administrative për bizneset, duke rritur efikasitetin dhe transparencën në sistemin inspektues të vendit, si dhe të krijojë edhe një sistem meritokracie për rekrutimin dhe zhvillimin e karrierës së inspektorëve.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat që synohen të realizohen përfshijnë:

- Përmirësimin e klimës së biznesit dhe krijimin e kushteve për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi;
- Garantimin e produkteve më të sigurta ushqimore dhe jo-ushqimore, një mjedis më të pastër dhe në zbatim të ligjit, kushte më të sigurta pune, si edhe veprimtari ekonomike në fushën e energjisë dhe transportit në përputhje me detyrimet ligjore;
- Garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe vendore, në Republikën e Shqipërisë;
- Menaxhimin dhe koordinimin më të mirë të Inspektorateve Qendrore;
- Implementimin e teknologjisë për të lehtësuar procesin e inspektimit, përfshirë kryerjen dhe raportimin e inspektimeve nëpërmjet sistemit unik të inspektimeve, që ulin kohën dhe kostot për të dyja palët, bizneset dhe administratën;
- Rregullimin e marrëdhënieve të punësimit dhe ngritjen e sistemit të rekrutimit dhe karrierës nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit profesional sipas fushës së inspektimit.
- Vendosja e një kulture parandaluese dhe edukative, duke përdorur paralajmërimin, si dënim administrativ kryesor, në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, si dhe këshillimin.
- Mundësimi i mbikëqyrjes së të gjithë sistemit të inspektimeve nga një bord inspektimi, i cili do të marrë vendimet kryesore strategjike dhe përcaktuese të politikave të përgjithshme të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standrave dhe metodologjive.
- Kryerja e inspektimeve bazuar në programe inspektimi, me bazë risku, të aplikuara për të gjitha fushat e inspektimit.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të

përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme, janë marrë në konsideratë për të realizuar politikat e ndërmarra të Qeverisë Shqiptare:

Opsioni i status quo, për mbajtjen e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pa ndryshimet e propozuara do të vijojë të mbajë në fuqi problematikat e shënuara më sipër, në të gjitha fushat e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni 1 – ndryshim i ligjit ekzistues 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Për shkak se ndryshimet e propozuara janë të shumta (mbi 50% e ligjit aktual) rrjedhimisht për efekt të teknikës legislative, ky opsion nuk është i favorshëm.

Opsioni 2 – propozimi i një projektligj të ri, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në propozimin për riorganizimin e trupave inspektuese qendrore nën përgjegjësinë e Ministrive të linjës, nën mbikëqyrjen e Inspektoratit të Përgjithshëm.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur **Opsioni 2**, pra miratimi i një ligji të ri që do të ofrojë rregullimin e duhur kuadër për sektorin e inspektimeve, në përshtatje me problematikat aktuale të shumta të këtij sektori dhe objektivat e përmendura më lart.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

- **Ndikimet ekonomike** të opsionit të preferuar nuk do të sjellë rritje të shpenzimeve në buxhet. Gjithashtu ndikimi ekonomik do të reflektohet në përfitime të biznesit në kohë/orë inspektimi në subjekt, si dhe kostove të pamatshme për procedimet administrative nga gjykata për masat administrative.
- **Përfitim ekonomik për sektorin publik**, si rezultat i riorganizimit të Inspektorateve Shtetërore, i cili do të sjellë reduktimin e disa zërave të shpenzimeve buxhetore si : transport, burime mbështetëse , kancelari, karburant, etj, të pamatshme.
- **Përfitimet cilësore kryesore**, do të vinë nga grupimi i të gjitha Inspektorateve Shtetërore dhe strukturave të tjera që do të përfshihen për zbatim të ligjit të ri për inspektimin, duke siguruar rritje cilësore të kapaciteteve kontribuese institucionale dhe me integritet të trupave inspektuese, nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar, bazuar në sistemin e karrierës. Përmes optimizimit e racionalizimit të mjediseve e ambienteve, synohet që të ketë një ndarje më racionale të detyrave e prioriteteve, nga e njëjta adresë gjeografike; koordinim më të mirë të ekipeve inspektuese të inspektorateve qendrore; pajisje e mjete më cilësore transporti e pajisje pune për ekipet inspektuese; më tepër eficiencë e përgjegjshmëri në reagimin ndaj kërkesave të qytetarëve; një adrese digjitale e vetme prej ku qytetari të bëjë një njoftim apo denoncim

dhe prej ku të ndjekë apo të marrë përgjigje për kërkesën e tij; një kod më të mirë veshje, sjellje e performancë prej inspektorëve të vendosura në të njëjtin objekt; burime njerëzore më të përqendruara e me ekspertizë në rritje; garantim të trajnimit e kualifikimit në vazhdimësi për të gjithë inspektorët, si dhe vlerësimin dhe ngritjen në karrierë; siguri e garanci më e lartë në mbajtjen e ruajtjen e regjistrimeve të çështjeve të inspektimeve, duke patur infrastrukturën elektronike, si dhe ofruesin e shërbimit Internet nga e njëjta qendër nga i njëjti ofrues; mekanizma më të mirë për rritjen e përgjegjësisë së inspektorëve shtetërorë, lehtësi e bizneseve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe shkëmbim të informacionit në kohë reale, etj.

- ***Ndikim ekonomik pozitiv për bizneset***, përfshijnë krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, garantimin e rregullave të njëjta në treg, rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Do të ketë gjithashtu edhe disa lloje ***ndikimesh pozitive jo të drejtpërdrejta ekonomike*** të mundshme, duke përfshirë formalizimin e ekonomisë me synim, uljen e barrës administrative dhe uljen e korrupsionit.
- ***Ndikim social pozitiv*** jo të drejtpërdrejtë, i cili konsiston në rritjen e besimit tek qytetarët për funksionimin dhe zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin në nivel më të lartë të sigurisë dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

- ***Ndikimet mjedisore***

Përmirësimi i cilësisë së inspektimeve në Republikën e Shqipërisë, do të sjellë ndikim indirekt edhe në cilësinë e mjedisit duke patur parasys, që përmirësimi përfshin Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Autoritetin Kombëtar të Mjedisit, përgjegjës për çështjet e mjedisit si dhe inspektoratet e tjera, të cilat bashkëpunojnë me të, për të njëjtën çështje. Gjithashtu riorganizimi i Inspektorateve, do të përmirësojë indirekt shkallën e ndotjes të ujërave, ajrit dhe tokës, do të përmirësojë dhe ruajë me përgjegjësi të lartë pyjet dhe kafshët e egra, do të ndikojë në mbrojtjen dhe sigurinë ushqimore të njerëzve, kafshëve etj.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është Opsioni 2, i cili propozon hartimin e një projektligji të ri “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky opsion parashikon njëkohësisht riorganizimin dhe konsolidimin e trupave inspektuese në Inspektorate të strukturuar sipas parimit “Një Ministri, një Inspektorat Shtetëror”, me përjashtime. Ky ristrukturim synon të maksimizojë efikasitetin e misionëve të tyre ligjore, duke garantuar që ato nuk kryhen në konflikt interesi apo me përplasje ligjore midis sektorëve të ngjashëm. Gjithashtu, pritet të çojë në një bashkëpunim ndërinstytucional më të mirë, me procedura inspektimi dhe veprimtari laboratorike më cilësore, efikase dhe ekonomike.

Përmirësimet cilësore në veprimtaritë inspektuese do të garantojnë inspektime me standarde bashkëkohore, me trupa inspektuese profesionale, me kushte më të mira pune dhe page, që ushtrojnë parimet bazë të ndryshuara në ligjin për inspektimin, nëpërmjet

sistemit të karrierës/klasifikimit me nivele të inspektorit.

Kërkesat ligjore që do të çojnë në *ofrim të shërbimeve ndaj Operatorëve të Biznesit me standarde bashkëkohore*, i janë referuar modeleve dhe praktikave më të mira të marra nga bashkëpunimi me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës, si dhe inspektorate homologe të vendeve të BE, modele të cilat kanë çuar në propozimin e opsionit preferencial:

Ky opsion do të sjellë më shumë përfitime sesa kosto, por vlera monetare e koston dhe e përfitimeve nga ndikimet e mundshme, është përcaktuar mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve të disponueshme.

Sidoqoftë, ato *janë vlerësuar në aspektin cilësor*, aty ku ka qenë e mundur. Përveç kësaj, ndikimi faktik do të ndihet pasi të hartohen dhe të miratohen aktet nënligjore.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

<i>në 000/lekë</i> Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsytet pse?)

Hartimi i ligjit të ri “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është kryer nga Grupi i Punës i dalë me Urdhrin nr. 242, datë 29.12.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për riorganizimin e inspektorateve”.

Për të mbështetur hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon riorganizimin e trupave inspektuese shtetërore sipas fushave të inspektimit me veprimtari të ngjashme dhe një menaxhim dhe koordinim më të mirë, është bashkëpunuar me përfaqësuesit e Shoqatave dhe Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë vendase e të huaja, si dhe janë mbështetur me ekspertizë nga ekspertë të UNDP.

Me këtë qasje, grupi ndërinstitucional, si dhe grupi ndërinstitucional teknik, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, finalizoi hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me objektivi riorganizimin e trupave inspektuese qendrore (shtetërore), sipas fushave të inspektimit me funksione të ngjashme inspektuese, si dhe për një menaxhim dhe koordinim më të mirë të të gjithë inspektorateve shtetërore/vendore, me synimin, ndër të tjera përmirësimin e klimës së biznesit në vend.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar vizita studimore dhe takime pune me Këshillin e Inspektimeve në Republikën e Sllovenisë, si dhe Inspektoratin Shtetëror të Republikës së Kroacisë. Këto takime synonin shkëmbimin e informacionit mbi mënyrën e organizimit të inspektorateve dhe veprimtarive inspektuese, rekrutimit dhe trajnimit të inspektorëve si dhe

eksperiencën në lidhje me procese të tjera të inspektimit.

Kjo qasje bashkëpunimi garanton se projektligji është i mbështetur nga njohuri të thella profesionale dhe konsultime të gjera me palët e interesuara, duke synuar të sjellë një ndryshim pozitiv në sistemin e inspektimeve në Shqipëri, për të rritur efikasitetin, transparencën dhe menaxhimin e veprimtarive inspektuese në përputhje me standardet më të larta.

Hartimi i projektligjit ka kaluar përmes një dialogu të vazhdueshëm me përfaqësues të ministrive dhe instucioneve të tyre të varësisë, për diskutimin e problematikave dhe formulimin e parashikimeve të duhura ligjore.

Varianti final i projektligjit për inspektimin ka kaluar përmes disa ndryshimeve si pasojë e sugjerimeve dhe komenteve në grupet e punës, takimeve konsultative me përfaqësues nga ministrinë dhe institucionet e tyre të varësisë, si dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në këtë variant final, në dispozitat e projektligjit janë reflektuar propozimet dhe ndryshimet si vijojnë:

Komentet dhe sugjerimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë pranuar dhe reflektuar në pjesën më të madhe të tyre. Përkufizimi mbi “inspektimin”, parashikuar në pikën 3, të nenit 4 është riformuluar sipas sugjerimit të tyre. Po ashtu, në të njëjtin nen është përcaktuar përkufizimi mbi monitorimin, ndërsa lidhur me miratimin e planeve vjetore të monitorimit nga ministri përgjegjës, është reflektuar në pikën 4, të nenit 32, pasi propozimi për të qëndruar në nenin 7 nuk qëndron, për shkak se ky nen përcakton një parim të përgjithshëm në inspektime.

Janë reflektuar plotësisht sugjerimet për nenin 13, pika 1, shkronja “c”, për heqjen e togfjalëshit “nëpërmjet sistemit të qendëruar të riskut”; për nenin 25, pika 1, lidhur me varësinë nga ministri përgjegjës, dhe nuk është pranuar i njëjti sugjerim për nenin 26, pika 2, pasi përbën përsëritje. Nuk është pranuar komenti tek neni 27, pika 3, ku kërkohet raportimi para ministrit përgjegjës dhe informimi i Inspektorit të Përgjithshëm, pasi kryeinspektori raporton para ministrit përgjegjës për zbatimin dhe implementimin e drejtiveve strategjike të ministrive dhe para Inspektorit të Përgjithshëm për veprimtaritë inspektuese. Komentet mbi nenin 33, shkronja “c” dhe nenin 51 lidhur me marrjen e mostrave janë reflektuar plotësisht.

Komentet e Ministrisë së Drejtësisë janë reflektuar plotësisht dhe konkretisht është riformuluar përcaktimi mbi parimin e dispozitës më të favorshme ligjore në pikën 1, të nenit 8 dhe përcaktimi mbi parimin e informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit. Propozimi për ndryshimin e nenit 20 që lidhet me marrëdhëniet e punësimit dhe kriteret për emërimin në pozicionin inspektor është pranuar dhe reflektuar. Komentet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit janë pranuar dhe reflektuar plotësisht, dhe konkretisht sipas komenteve në projektligj, në pikën 14, të nenit 4, fjala “platformë digjitale” është zëvendësuar me fjalën “sistem elektronik”, në pikën 1, të nenit 13, fjalët “në sistemet online” janë zëvendësuar me togfjalëshin “në sistemin elektronik “e-Inspektimi”, në nenin 18, shkronja “d”, fjala “zhvillime” është zëvendësuar me fjalën

“veprime” dhe neni 47 për sistemin elektronik “e-Inspektimi” është riformuluar sipas komenteve të përcjella.

Komentet e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në takimin e zhvilluar mbi identifikimin e akteve ligjore që preken nga projektligji për inspektimin, lidhur me shqyrtimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar janë reflektuar në pikën 1, të nenit 43, sipas të cilit vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga trupa inspektuese që ka kryer inspektimin, nëse nuk parashikohet ndryshe në ligjin e posaçëm.

Propozimet e Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, për të formuluar një përcaktim ligjor lidhur me marrjen e vendimit përfundimtar të inspektimit, aty për aty, janë reflektuar në pikën 3, të nenit 43.

Komentet e përfaqësuesve të njësive vendore në takimin e zhvilluar për diskutimin e projektligjit për inspektimin, lidhur me parashikimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit në projektligj, si dhe përfshirjen e një përfaqësuesi nga Inspektorati i Përgjithshëm Shtetëror dhe një përfaqësuesi nga biznesi, janë reflektuar në nenin 56 të projektligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, projektligji i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike për 20 ditë pune (31 Maj 2024 – 28 Qershor 2024), si dhe është zhvilluar takimi konsultativ me përfaqësues nga dhomat e tregtisë dhe industrisë dhe shoqatat e biznesit vendase dhe të huaja, ekspertë individualë dhe përfaqësues nga bota akademike (21 Qershor 2024). Komentet e përcjella përmes portalit të konsultimit publik dhe takimit konsultativ janë reflektuar në Raportin individual të konsultimit publik dhe komentet e pranuar janë reflektuar në përmbajtjen e projektligjit për inspektimin.

Konkretisht janë pranuar dhe reflektuar komentet dhe sugjerimet lidhur me parashikueshmërinë institucionale, si një nga prioritetet e kësaj reforme që lidhet me përmirësimin e klimës së biznesit, si dhe përfshirjen e ligjeve të posaçme të inspektorateve me qëllim përmirësimin e strukturuar dhe të qëndrueshëm të legjislacionit aktual, duke siguruar që të gjitha aspektet e inspektimit të jenë të koordinuara dhe të rregulluara në mënyrë efektive. Janë pranuar po ashtu komentet lidhur me njoftimin postar në nenin 43 të projektligjit. Është pranuar pjesërisht sugjerimi lidhur me afatin e njoftimit të inspektimit, dhe në nenin 40 të projektligjit afati u ndryshua nga 7 ditë në 10 ditë. Nuk janë pranuar apo reflektuar komentet që lidhen me përcaktimin e numrit maksimal të inspektimeve të programuara në ligj, pasi kjo çështje është vlerësuar të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të përcaktojë edhe përqindjen e inspektimeve jashtë programit, e cila nuk duhet të tejkalohet nga strukturat inspektuese. Po ashtu nuk janë pranuar edhe komentet lidhur me përcaktimin e afateve për korrigjimin e shkeljeve apo specifikimin e shkeljeve të rënda në ligj, për shkak të specifikës së secilit inspektorat, ligji nuk mund të ketë natyrë shteruese në këtë aspekt, ndaj vlerësohet të rregullohet me akt nënligjor.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar do të jenë, të gjitha ministrinë e linjës, të cilat kanë në varësi struktura si Inspektoratet Shtetërore dhe agjencitë/drejtoritë, të cilat kryejnë veprimtari inspektuese.

Monitorimi i politikës që propozohet, do të realizohet nga Bordi i Inspektimit, Inspektorati i Përgjithshëm si dhe 8 Inspektoratet Qendrore të propozuara.

Procesi i monitorimit të inspektorateve qendrore, do të jetë nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen metodologjike të Inspektoratit të Përgjithshëm përgjegjës për garantimin e ligjshmërisë në çështjet e inspektimit, rekrutimit, sistemit të karrierës dhe veprimtarisë laboratorike.

Inspektorati i Përgjithshëm, do të sigurojë funksionimin e një sistemi koherent të monitorimit dhe raportimit, pasi 8 Inspektoratet Qendrore duhet të shfrytëzojnë të njëjtin sistem të monitorimit dhe raportimit, për sa i përket formave (modeleve) dhe afateve. Inspektoratet do të raportojnë për veprimtarinë inspektuese tek Ministri përgjegjës dhe Inspektori i Përgjithshëm Shtetëror.

Monitorimi do të kryhet, duke u bazuar tek të dhënat e inspektimeve online dhe rezultatet e inspektimeve të realizuara sipas vlerësimit të riskut, masave administrative të marra, referuar ankimeve të operatorëve të biznesit në lidhje me procedurat e inspektimit si dhe ankesat e qytetarëve.

Monitorimi i Inspektorateve do të jetë një proces i vazhdueshëm i grumbullimit sistematik të të dhënave, në pajtim me indikatorët e caktuar, me qëllim vëzhgimin e shkallës së progresit dhe të realizimit të objektivave dhe politikave të vendosura.

Inspektorati i Përgjithshëm Shtetëror do të raportojë për veprimtarinë inspektuese në Republikën e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës

Në vitin 2009 projekti BERIS² i Qeverisë Shqiptare në bashkëpunim me Bankën Botërore, kreu një analizë të thelluar të problemeve, dobësive dhe kostove të inspektimeve mbi biznesin. Deri në vitin 2011 kishte 33 trupa inspektuese, të cilat me hyrjen në fuqi të ligjit për inspektimin³, u reduktuan në 16 trupa inspektuese. Më pas gjatë viteve përsëri numri i

² Reform of the Inspection System in Albania. Preliminary Impact Assessment. "Business Environment Reform and Institutional Strengthening" (BERIS). **Tirana, 4 December 2009.**

³ Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

institucioneve me funksione inspektimi u rrit, duke qenë në vitin 2024 në 23 inspektorate dhe institucione me funksione inspektimi. Lista e inspektorateve gjendet ne faqen zyrtare të sistemit elektronik “e-Inspektimi”⁴, i cili është krijuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”.

Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, që nga miratimi i tij në vitin 2011, nuk ka pësuar asnjë ndryshim ligjor deri me sot.

Në kuadër të ligjit ekzistues, Inspektoratet janë trupa ekzekutive dhe administrative, nën përgjegjësinë e një ministrie, dhe kujdesen për zbatimin e legjisllacionit në fuqi dhe që mbulojnë një fushë të caktuar. Ligji unik i inspektimeve, ka të përcaktuar organizimin dhe funksionimin e inspektorateve, por ndarja e përgjegjësisë të inspektorateve ka bërë të ketë mbivendosje të kompetencave të atyre në nivel qendror, dhe drejtorive në nivel rajonal. Inspektoratet grupohen në tri grupe:

- ✓ Inspektorate që funksionojnë vetëm në nivel qendror;
- ✓ Inspektorate që, përveç nivelit qendror, funksionojnë edhe me drejtori rajonale;
- ✓ Inspektorate, që kanë varësinë nga një institucion tjetër.

Në disa raste ekzistojnë konflikte kompetencash mes nivelit qendror/lokal dhe atij ministror, megjithëse fushë veprimtaria e këtyre inspektorateve rregullohet me ligje të veçanta, në praktikë janë hasur pengesa të shumta mes inspektorëve të nivelit qendror dhe atyre lokal.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematikat në Inspektoratet Shtetërore vijnë si pasojë e disa shkaqeve, si hendeqet/boshllëqet e ligjit aktual, ligji është relativisht i vjetër në kohë, nuk ka pësuar ndryshime dhe nuk i përgjigjet nevojave aktuale, krijon paqartësi në ndarjen e kompetencave etj.

Bazuar në studimin e objektit të punës së Inspektorateve Shtetërore, strukturës, numrit të punonjësve, numrit të subjekteve të inspektuara, nivelit profesional, akteve administrative të shqyrtuara nga Inspektorati Qendror etj, konstatohen problematikat si vijon:

⁴ <https://e-inspektimi.gov.al/SitePages/Home.aspx>

1. Vështirësi në aplikimin e ligjit 10433/2011, të lidhura kryesisht me arsye strukturore. Ligji nuk mundëson një dialog institucional të rregullt midis Inspektoratit Qendror me inspektoratet e tjera dhe ministritë respektive. Vështirësitë kryesore lidhen me mbivendosjet e funksioneve, me diskutimet për përmirësimin e sistemit elektronik, diskutimet e vendosjet e sistemeve të riskut në inspektorate specifike, organizimet e trajnimeve, etj.
2. Numri i lartë i institucioneve me funksione inspektuese, që sjellin përplasje të kompetencave. Ky konflikt vjen si pasojë e mungesës së një linje të qartë ndarëse të kompetencave ligjore, ç'ka rezulton në mbivendosje të autoriteteve (inspektime të dublikuara me kërkesa ligjore të njëjta nga inspektoratet shtetërore të ndryshme) dhe në një bashkëpunim të mangët ndërinstitucional (barriera të komunikimit).
3. Numër i lartë i inspektimeve, i shoqëruar nga një numër i lartë i inspektimeve të paplanifikuara në rreth 30%, të cilat sjellin një barrë të konsiderueshme tek biznesi. Gjithashtu kryerje e një numri të konsiderueshëm inspektimesh të pabazuara në metodologji dhe vlerësim risku për strukturat e pa përfshira në sistemin unik elektronik “e-inspektimi” dhe ligjin për inspektimin. Sistemi aktual i inspektimeve vuan nga mungesa e një procesi të përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit në bazë të riskut. Ekziston një praktikë e zgjedhjes së inspektimeve në mënyrë subjektive, e cila ofron mundësinë për abuzime dhe korrupsion. Nevojitet përmirësimi i planifikimit të inspektimeve me bazë riskun, duke kufizuar inspektimet e paplanifikuara.
4. Ka veprimtari inspektuese të evidentuara në Republikën e Shqipërisë që nuk kryejnë procedura inspektimi online, të cilat duhet të përfshihen në rrjetin e shërbimeve publike të modernizuara, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e të gjithë procesit nëpërmjet infrastrukturës digjitale.
5. Mungesë transparence gjatë veprimtarisë së inspektimit në subjekt për strukturat e pa përfshira në sistemin unik elektronik “e-inspektimi” dhe ligjin për inspektimin. Veprimtaria inspektuese aktualisht karakterizohet nga mungesa e transparencës dhe efikasitetit, duke lënë hapësira për praktika korruptive dhe një barrë të rëndë administrative mbi biznesin. Bizneset kanë paqartësi dhe mungesë informimi për përmbushjen e kërkesave ligjore.
6. Ushtrimi i veprimtarisë inspektuese ndikohet nga mungesa e pavarësisë në vendimmarrje dhe nga ndikimi politik, që dëmton integritetin e proceseve inspektuese. Nevojitet garantim i pavarësisë në vendimmarrje të trupës inspektuese, pa efektin interferues politik.
7. Procedurat rregullatore të tilla si: regjistrimi, licencimi apo marrja e lejeve, si të drejta për ushtrimin e një aktiviteti të caktuar nga Operatorët e Biznesit, kryhen nga e njëjta strukturë institucionale duke krijuar situatë në konflikt interesi.
8. Shqyrtim i ankimit të subjektit, nga trupë kolegjiale e ngritur në konflikt interesi, brenda organit, i cili kryen edhe kontrollin ligjor në subjekt. Kjo rezulton në një mungesë të pavarësisë në komisionet e ankimit të gjobave dhe masave administrative, të cilat janë

ngritur pranë inspektorateve përkatëse dhe për pasojë vetëm 6% e vendimeve ankimohen. Ka nevojë për të siguruar më shumë pavarësi dhe transparencë në procesin e ankimit.

9. Ka një mungesë të vlerësimit të performancës së inspektorateve në lidhje me ndikimin që ata kanë në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushat përkatëse. Kjo sjell nevojën për të përcaktuar metodologji specifike për matjen e performancës në bazë të ndikimit shoqëror që ka inspektimi përkatës (siç janë për shembull ulja e aksidenteve në punë, ulja e ndotjes mjedisore, etj.).

10. Sistemi aktual i marrëdhënieve të punësimit është me dy standarde të ndryshme për inspektorët - sipas Kodit të Punës dhe statusit të nëpunësit civil, duke krijuar një mungesë kohezioni në mënyrën se si trajtohen inspektorët. Në të njëjtën kohë, ky sistem aktualisht realizohet pjesërisht nga inspektoratet përkatëse ose Departamenti i Administratës Publike për pjesën e rekrutimit dhe nga Inspektorati Qendror për pjesën e trajnimit dhe testimit, duke sjellë një mungesë harmonizimi në praktikat më të mira për të siguruar profesionalizmit e trupës së inspektimit.

11. Probleme të tjera përfshijnë: kapacitete institucionale të pamjaftueshme; mungesë të kushteve të punës; mungesë për pajisje dhe materiale laboratorike si dhe mjete të tjera logjistike; ushtrimi i veprimtarisë inspektuese nga një inspektor i vetëm; trupa inspektimi, të pa kualifikuara, pa arsimin përkatës, të cilat sjellin mungesë të monitorimit të zbatueshmërisë së kuadrit rregullator nga bizneset dhe jo vetëm; nivel të ulët page për inspektorin.

12. Inspektoratet shtetërore nuk marrin masa disiplinore ndaj inspektorëve, kur shqyrtojnë vendime administrative të marra në subjekt prej tyre, të cilat i shfuqizon komisioni i shqyrtimit të ankesave brenda institucionit.

Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në ushtrim të kompetencave administrative, inspektuese në subjekt në paligjshmëri, në formë permanente dhe duke u bërë për Operatorët e Biznesit, barrë administrative dhe hallkë korruptive gjatë inspektimeve të të gjitha fushave, në Republikën e Shqipërisë.

Shtirja e këtyre problematikave përfshin të gjithë inspektoriatet dhe inspektorët që operojnë në Republikën e Shqipërisë, si dhe operatorët e biznesit.

Grupet e prekura janë:

- ✓ Punonjësit e inspektoriateve;
- ✓ Strukturat shtetërore dhe Qeveria;
- ✓ Operatorët e biznesit, të cilët operojnë në vend;
- ✓ Investitorët e huaj, të cilët kanë interesin për të ushtruar aktivitet ekonomik në Shqipëri;

- ✓ Konsumatorët/ qytetarët dhe shoqëria civile.

Në përfundim, vlerësojmë se të gjithë problematikat e konstatuara më lart mund të trajtohen vetëm përmes një ndryshimi të politikave.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Politika e Qeverisë Shqiptare në Programin Qeverisës 2021-2025, flet për krijimin e besimit të qytetarëve, për një të ardhme moderne të Shqipërisë, duke luftuar korrupsionin, informalitetin, klientelizmin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin. Modernizimin e shërbimeve dhe infrastrukturës digjitale si një instrument i patjetërsueshëm dhe i pazëvendësueshëm për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur në mënyrë të shpejtë cilësinë e shërbimeve ndaj publikut si dhe produktivitetin e sipërmarrjes.

Në vazhden e shumë reformave të deritanishtme, të lidhura dhe me procesin e dixhitalizimit dhe fiskalizimit, janë përmirësuar shumë elementë të marrjes së shërbimeve të bizneseve në administratën shtetërore dhe në pakësimin e kontakteve të drejtpërdrejta në mes të bizneseve të administratës. Një nga fushat ku këto përmirësime kanë qenë më të avashta dhe ku ankesat e bizneseve janë përsëri të ndjeshme është fusha e inspektimit.

Ndërhyrja e Qeverisë është e nevojshme sepse ka veprimtari inspektuese të evidentuara në Republikën e Shqipërisë që nuk kryejnë procedura inspektimi online, ku sipas programit të Qeverisë⁵, duhet të përfshihen në rrjetin e shërbimeve publike të modernizuara, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e të gjithë procesit nëpërmjet infrastrukturës digjitale.

Ka ende nevojë për ndërhyrje të cilat do të rrisin efektin e garancisë së pavarësisë në vendimmarrje të trupave inspektuese duke minimizuar më shumë kontrollin politik si dhe interferencat e ministrive përgjegjëse.

Aktualisht mbikëqyrja e veprimtarive inspektuese në Republikën e Shqipërisë kryhet nga një strukturë qendrore (Inspektorati Qendror) e pakompletuar me autoritetin e nevojshëm rregullator. Inspektoratet përfaqësohen me nivel të ulët profesionalizmi, me përplasje administrative e të përfshira në kushte jo të përshtatshme infrastrukturore, me inspektorë të pakualifikuar, me emëtime nepotike, pa meritokraci dhe sistem karriere.

⁵ Kreu "Modernizim për Zhvillim", ku citohet se modernizimi i shërbimeve dhe infrastrukturës digjitale është një instrument i pazëvendësueshëm për luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e shpejtë të cilësisë së shërbimeve publike, si dhe produktivitetit të sipërmarrjes.

Forcimi i kuadrit ligjor rregullator në fushën e inspektimeve do të mundësojë ngritjen e një sistemi rekrutimi dhe karriere mbi baza meritokracie, ushtrimin e të gjithë veprimtarisë inspektuese konform legjislacionit për inspektimin, shmangien e mbivendosjes së kompetencave ligjore dhe uljen e barrës administrative ndaj biznesit.

Qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje kërkon të mundësojë ndër të tjera:

- Krijimin e një sistemi i cili rregullon marrëdhëniet e punësimit të punonjësve me një standard, siguron trajnimin, testimin dhe vlerësimin me nivele të inspektorëve, si dhe krijimin e një sistemi të pavarur për ngritjen në karrierë të inspektorit;
- Krijimin e një komisioni për shqyrtimin e ankimit administrativ, pa konflikt interesi;
- Ofrimin e një sistemi unik të inspektimeve e-Inspektimi për veprimtaritë inspektuese në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet të cilit do të realizohet vlerësimi i riskut dhe komunikimi me publikun;
- Krijimin e besimit qytetar për funksionimin dhe zbatimin e ligjit është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm në cilësinë e jetës së konsumatorëve, por edhe në krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi;
- Krijimin e frymës pozitive për bizneset duke ofruar një qasjeje më transparente të veprimtarive inspektuese, me ofrimin e informacionit të nevojshëm për bizneset e reja, cilësi në inspektime, thjeshtësi në aplikimet dhe përcjelljen e dokumentacionit të inspektimit në kohë reale, pa inspektime të shpeshta;

Kjo ndërhyrje synon të realizohet përmes sigurimit të një sistemi monitorimi dhe mbikëqyrjeje efektive dhe jo thjesht në kuadrin e formalitetit, në lidhje me impaktin gjithëpërfshirës që do të sjellin veprimtaritë inspektuese në vendin tonë.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për përmirësimin e ndjeshëm të të gjithë problematikave të evidentuara dhe kalimin e sistemit të inspektimeve shtetërore/vendore në Republikën e Shqipërisë në një qasje të re, model për vendet e rajonit dhe më gjerë.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat që synohen të realizohen përfshijnë:

- Përmirësimin e klimës së biznesit dhe krijimin e kushteve për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi;
- Garantimin e produkteve më të sigurta ushqimore dhe jo-ushqimore, një mjedis më të pastër dhe në zbatim të ligjit, kushte më të sigurta pune, si edhe veprimtari ekonomike në fushën e energjisë dhe transportit në përputhje me detyrimet ligjore;
- Reduktimin e numrit të inspektimeve në operatorët e biznesit, prej dublikimeve si dhe prej disa fushave të inspektimit, deri në një nivel prej 40%;
- Uljen e barrës administrative ndaj subjektit, si dhe kostos në kohë/orë inspektimi në subjekt, deri në një nivel prej 40%;
- Uljen e numrit të ankimeve të subjekteve që I drejtohen gjykatës për shqyrtimin e procedurave të inspektimit me masë administrative;
- Implementimin e teknologjisë për të lehtësuar procesin e inspektimit, përfshirë kryerjen dhe raportimin e inspektimeve nëpërmjet sistemit unik të inspektimeve, që ulin kohën dhe kostot për të dyja palët, bizneset dhe administratën;

Rregullimin e marrëdhënieve të punësimit dhe ngritjen e sistemit të rekrutimit dhe karrierës nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit profesional sipas fushës së inspektimit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsionet e mëposhtme, janë marrë në konsideratë për të realizuar politikat e ndërmarra të Qeverisë Shqiptare:

Opsioni i status quo, për mbajtjen e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pa ndryshimet e propozuara do të vijojë të mbajë në fuqi problematikat e shënuara më sipër, në të gjitha fushat e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Ky opsion nuk është i përshtatshëm për shumë arsye. Së pari, pasi ushtrimi i veprimtarisë inspektuese në vend, me 16 inspektorate me fusha inspektimi të ndara, do të thotë që nuk kemi përmirësim të situatës së inspektimeve në vend dhe problematikat e hasura janë të qëndrueshme dhe të pakontrollueshme, gjë e cila bie ndesh me qëllimin e politikave të ndërmarra në këtë fushë.

Problematikat e hasura gjatë veprimtarive inspektuese mbeten aktive, psh. nuk mundëson pasjen e një Bordi Inspektimeshme kompetenca të rëndësishme, që mund të drejtohej nga një anëtar i Këshillit të Ministrave dhe që mund të merrte vendime të rëndësishme për vendosjen e objektivave të performancës dhe mbikqyrjen jo vetëm të Inspektoratit Shtetëror, por të të gjithë inspektorateve. Ky opsion nuk lejon ndryshimet ligjore që mundësojnë krijimin e një sistemi rekrutimi dhe ecurie në karrierë që drejtohet nga Inspektorati Shtetëror.

Ligji ekzistues nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka parashikuar në fushën e inspektimeve pikat si më poshtë:

- ✓ Rregullimin e sistemit të rekrutimit të inspektorëve me një model, sipas ligjit për inspektimin.
- ✓ Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve profesionale të rekrutimit dhe të karrierës.
- ✓ Përcaktimin e performancës së inspektorëve nëpërmjet niveleve të inspektori.
- ✓ Krijimin e rregullave për testimin fillestar dhe atë periodik të inspektorëve.
- ✓ Përfshirjen e Inspektoratit të Përgjithshëm, në monitorim të procedurës së inspektimit në terren, dhe në të drejtën e inicimit të një inspektimi me arsye.
- ✓ Realizimin e një procesi në shqyrtimin e ankimit që të jetë i pavarur nga inspektorati që ka vendosur masat administrative.

Opsioni 1 – ndryshim i ligjit ekzistues 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky opsion përmbush një pjesë të mirë të ndryshimeve të mundshme.

Ligji ekzistues nuk ka një përshtatje të plotë me disa nga parimet kryesore të OECD-së në lidhje me inspektimet. Fakti që ky ligj është miratuar në vitin 2011 dhe nuk është realizuar asnjë ndryshim gjatë këtyre viteve, pavarësisht nevojave për ndryshime, vërtet me gjasë si pasojë e vetë parashikimeve të këtij ligji që nuk lehtëson koordinimin midis institucioneve. Në të njëjtën kohë mungesa e këtyre ndryshimeve ka sjellë më shumë nevoja për ndryshime gjatë viteve. Për pasojë ndryshimet e propozuara janë të shumta (mbi 50% e ligjit aktual) dhe rrjedhimisht për efekt të teknikës legislative, ky opsion nuk është i favorshëm.

Opsioni 2 – hartimi/miratimi i një ligji të ri (opsioni i preferuar), bazuar në propozimin për riorganizimin e trupave inspektuese qendrore nën përgjegjësinë e Ministrive të linjës, nën mbikëqyrjen e Inspektoratit të Përgjithshëm.

Miratimi i një ligji të ri që do të ofrojë rregullimin e duhur kuadër për sektorin e inspektimeve, në përshtatje me problematikat aktuale të shumta të këtij sektori dhe objektivat e përmendura më lart. Ky opsion, në përpjekje për të arritur një efikasitet dhe cilësi më të lartë ekonomike në veprimtarinë e inspektimit synon:

- Riorganizimin e inspektorateve shtetërore dhe agjencive me funksione inspektuese në një numër inspektoratesh sipas fushave përkatëse të inspektimit.
- Ndarjen e përgjegjësisë midis veprimtarive inspektuese qendrore dhe vendore;
- Koordinimin vertikal dhe horizontal, me trupa inspektuese të përqendruara dhe organizuara më me efektivitet edhe në nivelin infrastrukturor;
- Bashkëpunim me ministritë e linjave për marrjen e politikave, dhe dhënie informacioni për veprimtaritë inspektuese të realizuara;

- Bashkërendimin dhe përcaktimin e politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, nëpërmjet Bordit të Inspektimit, si organ bashkërendues, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm;
- Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit administrativ si organ kolegjal, i cili nuk ushtron funksion në konflikt interesi;

Krijimin e një bazë ligjore që rregullon marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve, ngritjen e një sistemi të rekrutimit dhe karrierës për inspektorët, me qëllim nxitjen e profesionalizmit dhe eliminimin e konflikteve të kompetencave ligjore mes institucioneve, si dhe përmirësimet në ligj për të shmangur nene që mund të shërbejnë si burim i abuzimeve dhe keqinterpretimit nga ana e inspektorëve.

Opsionin 1 dhe 2, paraqesin përfitime të ndjeshme.

Implementimi i ndryshimeve në ligjin për inspektimin sipas këtyre dy opsioneve, bën të mundur realizimin e objektivave të cilat ka analizuar Inspektorati Qendror, konkretisht:

- ***riorganizimi i 16 inspektorateve, sjell reduktim të posteve të punës, të shërbimeve mbështetëse si dhe nuk ka ndikim në buxhet*** për shkak të shtimit të numrit të punonjësve në Inspektoratin e Përgjithshëm, pasi riorganizimi do të shoqërohet me rialokimin e pozicioneve të punës; trupat inspektuese nuk do të organizohen me 1 - 2 inspektorë, por ***me të paktën 3 inspektorë***;
- do të garantojë ***aplikimin e nivelit të riskut nëpërmjet sistemit të digjitalizuar unik*** për të gjitha fushat e inspektimit;
- do të garantohet, ***ulje e barrës administrative ndaj subjektit si dhe kostos në kohë/orë inspektimi në subjekt***;
- do të garantojë ndërtimin e një kulture parandaluese, duke vendosur paraljmërimin, si dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë, si dhe këshillimin mbi synimin për ndëshkim.
- ***marrëdhëniet e punësimit të inspektorit*** do të rregullohen me ligjin për inspektimin;
- rekrutimi i inspektorëve, ***kryhet sipas ligjit për inspektimin***;
- ***nuk ka problem të pabarazisë në pagat e inspektorëve*** duke qenë se performanca e mirë bën diferencën në klasa dhe nivele;
- ***ka përmirësim cilësor të inspektimeve*** nga riorganizimi me funksione të njëjta apo sipas parimit, një inspektorat një ministri;

- do të **ulet numri i inspektimeve** të paprogramuara nga **40%** në **20% duke marrë parasysh edhe drejtoritë/agjencitë e evidentuara që nuk zbatojnë ligjin për inspektimin**;;
- **koha e qëndrimit në subjekt gjatë një viti kalendarik do të reduktohet** ndjeshëm për shkak të bashkërendimit të fushave të inspektimit;
- **ndarje dhe funksion të qartë jashtë klientelizmit dhe konfliktit të interesit** të strukturave ministrore apo agjencive të varësisë që sot kryejnë funksione inspektimi, funksione shërbimi (inspektim, licencim, monitorim, koordinim) dhe politikë-bërje;
- rekrutimi i inspektorëve do të bëhet me **sistem karriere nëpërmjet niveleve të inspektorit**, jashtë ndikimit politik, bazuar në meritokraci dhe konkurrencë të ndershme;
- do të garantohen **procedura inspektimi cilësore, profesionale dhe ligjore**;
- do të rritet përqindja e subjekteve që kryejnë apelim ndaj masave administrative dhe gjobave, në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimimeve, për shkak të pavarësisë së këtij komisioni dhe rritjes së besimit ndaj veprimtarisë së tij.

do të **ulet përqindja e ankimimeve të subjekteve që i drejtohen gjykatës** për shqyrtim, të procedurave të inspektimit me masë administrative; Do të ngrihet Bordi i Inspektimeve, si një organ bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

Opsioni i preferuar për arritjen e objektivit të ndërmarrë është hartimi/miratimi i projektligjit të ri për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe riorganizimi i strukturave inspektuese me sistem vertikal, të cilat së bashku me inspektimin online tashmë të realizuar, do të standardizojnë dhe rregullojnë, me akte ligjore dhe nënligjore, funksionim optimal të digjitalizuar dhe jashtë mundësive korruptive. Implementimi i opsionit të preferuar mendohet se **kërkon më pak kohë dhe më pak shpenzime buxhetore për t'u realizuar.**

Vlen për t'u theksuar se, nga institucionet me funksione inspektuese, për të qenë pjesë e Inspektorateve të riorganizuara, janë marrë në konsideratë vetëm strukturat të cilat kryejnë veprimtari inspektimi (drejtori/agjenci).

Opsionet janë zgjedhur duke studiuar në formë të veçantë organikat, detyrat funksionale si dhe bazën ligjore me të cilën funksionojnë të gjitha Inspektoratet, Drejtoritë dhe Agjencitë me funksione të ngjashme inspektuese, që janë përfshirë në këtë skemë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*

- *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura nga opsionet janë:

- ✓ Punonjësit e inspektoriateve;
- ✓ Strukturat shtetërore dhe Qeveria;
- ✓ Operatorët e biznesit, të cilët operojnë në vend;
- ✓ Investitorët e huaj, të cilët kanë interesin për të ushtruar aktivitet ekonomik në Shqipëri;
- ✓ Konsumatorët/qytetarët dhe shoqëria civile.

Në kuadër të analizës së ndikimeve, parashtrohen ndikimet e mëposhtme:

Ndikimet ekonomike

1. Zgjerimi i një institucioni si Inspektorati Qendror (Inspektorati i Përgjithshëm), nuk do të kërkojë fonde shtesë nga buxheti i shtetit. Riorganizimi i inspektorateve dhe agjencive me funksione inspektuese do të sjellë dhe rialokim të pozicioneve të punës..
2. Reduktimi i 16 Inspektorateve shtetërore në 8 të tilla, do të sjellë ulje të shpenzimeve për paga si dhe do të mundësohet, ulje e barrës administrative ndaj subjektit si dhe kostos në kohë/orë inspektimi në subjekt.

3. Të gjitha këto ndryshime do të prekin inspektoratet shtetërore të qendëruara si dhe ato të cilat janë me organizim vertikal me degë rajonale.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik

Grupimi i të gjitha fushave të inspektimit në 8 Inspektorate qendrore, do të rrisë bashkëpunimin e trupave inspektuese dhe realizimin e inspektimeve të përbashkëta me kosto sa më të ulët administrative. Përmes optimizimit e racionalizimit të strukturave, synohet që të ketë një ndarje me racionale të detyrave e prioriteteve nëpërmjet sistemit unik të inspektimeve; pajisje e mjete më cilësore elektronike e transporti, për ekipet inspektuese; burime njerëzore më të përqendruara e me ekspertizë në rritje; siguri e garanci më e lartë në mbajtjen e ruajtjen e regjistrimeve të çështjeve të inspektimeve, duke e patur infrastrukturën elektronike, si dhe ofruesin e shërbimit Internet nga e njëjta qendër, nga i njëjti ofrues.

Kosto për buxhetin – nuk ka.

<i><u>Në 000/ lekë</u></i>		
Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
0	0	0

4. Pritet të ketë më pak subjekte që i drejtohen gjykatës për shqyrtim të ankimimeve për procedurat e inspektimit me masë administrative, gjë e cila do të përmirësojë klimën e biznesit në vend dhe do të rrisë shancet për investime të huaja në vend.
5. Fondet për kryerjen e veprimtarisë së Inspektoratit të Përgjithshëm, do të financohen nga të ardhurat e tjera të krijuara nga burime të ligjshme, duke përfshirë: donacionet, financimet, grandet si dhe aktivitetet e tjera.
6. Përfitim ekonomik për sektorin publik, si rezultat i riorganizimit të Inspektorateve Shtetërore, i cili do të sjellë reduktimin e disa zërave të shpenzimeve buxhetore si : transport, burime mbështetëse , kancelari, karburant, etj, të cilat janë të vështira të vlerësohen në këtë moment sepse behet fjale per nje proces shume kompleks qe do te realizohet me ndryshime te tjera ligjore.

Përfitimet cilësore kryesore, do të vinë nga grupimi i të gjitha Inspektorateve Shtetërore dhe strukturave të tjera që do të përfshihen për zbatim të ligjit të ri për inspektimin, duke siguruar rritje cilësore të kapaciteteve kontribuese institucionale dhe me integritet të trupave inspektuese, nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar, bazuar në sistemin e karrierës.

Përmes optimizimit e racionalizimit të mjediseve e ambienteve, synohet që të ketë një ndarje më racionale të detyrave e prioriteteve, nga e njëjta adresë gjeografike; koordinim më të mirë të ekipeve inspektuese të inspektorateve qendrore; pajisje e mjete më cilësore transporti e pajisje pune për ekipet inspektuese; më tepër eficiencë e përgjegjshmëri në reagimin ndaj kërkesave të qytetarëve; një adrese digjitale e vetme prej ku qytetari të bëjë një njoftim apo denoncim dhe prej ku të ndjekë apo të marrë përgjigje për kërkesën e tij; një kod më të mirë veshje, sjellje e performancë prej inspektorëve të vendosura në të njëjtin objekt; burime njerëzore më të përqendruara e me ekspertizë në rritje; garantim të trajnimit e kualifikimit në

vazhdimësi për të gjithë inspektorët, si dhe vlerësimin dhe ngritjen në karrierë; siguri e garanci më e lartë në mbajtjen e ruajtjen e regjistrimeve të çështjeve të inspektimeve, duke patur infrastrukturën elektronike, si dhe ofruetin e shërbimit Internet nga e njëjta qendër nga i njëjti ofruer; mekanizma më të mirë për rritjen e përgjegjësisë së inspektorëve shtetërorë, lehtësi e bizneseve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe shkëmbim të informacionit në kohë reale, etj.

Përfitimi kryesor i drejtpërdrejtë ekonomik që pritet të vijë si rezultat i kësaj politike, do të jetë ai që do të marrin inspektorët në formën e pagave të unifikuara.

7. Propozimi gjithashtu pritet të sjellë përfitime të drejtpërdrejta ekonomike për sektorin publik, shoqërinë dhe ekonominë e gjerë. Funkcionet administrative të Inspektoratit të Përgjithshëm, të tilla si mbikëqyrja, koordinimi, vlerësimi i analizës së riskut për veprimtaritë inspektuese të të gjitha fushave në nivel rajonal dhe lokal si dhe garantimi cilësisë dhe sigurisë të të gjitha produkteve, dhe menaxhimi nëpërmjet inspektimit me përgjegjësi dhe profesionalizëm të lartë i të gjithë aseteve natyrore të vendit, do të sjellin rritje ekonomike të drejtpërdrejta. Vlera monetare e këtyre përfitimeve nuk është përcaktuar për shkak të natyrës së pakthyeshme.
8. Propozimi gjithashtu pritet të sjellë përfitime të drejtpërdrejta ekonomike për bizneset që përfshijnë uljen e kostove administrative (kosto në kohë). Kostoja në kohë e procedurës së inspektimeve pranë bizneseve, pritet të ulet akoma më shumë duke marrë parasysh edhe mbikëqyrjen nga Inspektorati i Përgjithshëm, i cili referuar planeve mujore të 6 (gjashtë) inspektorateve, do të koordinojë inspektime të përbashkëta në një subjekt, të dy ose më shumë inspektorateve. Nga llogaritja e raportit kosto- efektivitet, është matur efektiviteti i secilit opsion sipas tabelës më poshtë. Numri i inspektimeve, në Operatorët e Biznesit, sipas Statusquo është 110,000 inspektime/vit, dhe sipas Opsionit 1 dhe Opsionit 2 rreth 70,000 inspektime/vit.. Kohëzgjatja e një procedure inspektimi pranë operatorit është 4 orë. Numri i bizneseve që inspektohen në të gjithë territorin e Shqipërisë është rreth 60 000 biznese.

Duke iu referuar Status- quo, numri i orëve që shpenzohet pranë bizneseve, për procedurën e inspektimit për një vit (kosto në kohë) është: $110\ 000\ \text{inspektime/vit} * 4\ \text{orë (kohëzgjatja e një inspektimi)} = 440\ 000\ \text{orë/vit}$.

Duke iu referuar Opsionit 1 dhe Opsionit 2, numri i orëve, që shpenzohet pranë bizneseve, për procedurën e inspektimit për një vit (kosto në kohë) është: $70\ 000\ \text{inspektime/vit} * 4\ \text{orë (kohëzgjatja e një inspektimi)} = 280\ 000\ \text{orë/vit}$.

Tabela e llogaritjes se kosto- efektivitetit të opsioneve

Opsionet	Kosto në kohë (ore inspektimi pranë bizneseve)	Njësi efektiviteti (Numri I bizneseve)	Raporti	Rezultatet
Status quo	440 000 orë në vit, për procedurën e	60 000 biznese që inspektohen në territorin e	7.33	7.33 orë do të shpenzohen për inspektim pranë një subjekti mesatarisht për 1

	inspektimeve	Shqipërisë		vit
Opsioni 1 <i>Pa inspektimet ne nivel lokal.</i>	280 000 orë në vit për procedurën e inspektimeve	60 000 biznese që inspektohen në territorin e Shqipërisë	4.66	4.66 orë do të shpenzohen për inspektim pranë një subjekti mesatarisht për 1 vit
Opsioni 2	280 000 orë në vit për procedurën e inspektimeve	60 000 biznese që inspektohen në territorin e Shqipërisë	4.66	4.66 orë do të shpenzohen për inspektim pranë një subjekti mesatarisht për 1 vit

Analiza e kostove në kohë, sipas tabelës tregon se Opsioni 2 është opsioni i rekomanduar për zbatim sepse ka vlerën më të ulët të raportit. Vlerat e raportit tregojnë kohën mesatare të inspektimit nga trupa inspektuese pranë një subjekti për një vit, pa marrë parasysh inspektimet e tjera të kryera jashtë programit: inspektime në kushtet e flagrancës, verifikimi i detyrave të lëna, aksidente, inspektime me urdhër të posaçëm, të parashikuara në ligjin për inspektimin.

Ndikim ekonomik pozitiv për bizneset, përfshijnë krijimin e një klime të favorshme për zhvillimin e konkurrencës së ndershme, garantimin e rregullave të njëjta në treg, rritjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Sa më të qarta të jenë bizneset për inspektimet, sa më të lidhura të jenë këto inspektime me riskun e këtyre aktiviteteve dhe mundësisë për shkelje dhe sa më transparente të jenë listat e verifikimit që përdoren nga inspektorët, aq më shumë do të krijohen kushtet për të realizuar në mënyrë të rregullt aktivitete biznesi.

Do të ketë gjithashtu edhe disa lloje ***ndikimesh pozitive jo të drejtpërdrejta ekonomike*** të mundshme, duke përfshirë formalizimin e ekonomisë me synim, uljen e barrës administrative dhe uljen e korrupsionit.

9. Përveç efekteve të drejtpërdrejta ekonomike të diskutuara më sipër, ekziston edhe potenciali i efekteve ekonomike jo të drejtpërdrejta, pasi përmirësimi i aktivitetit të bizneseve do të sjellë rritje ekonomike, e cila mund të shoqërohet me shtim të vendeve të punës, si dhe mund të ndikojë në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB).
10. Propozimi gjithashtu pritet të sjellë përfitime ekonomike jo të drejtpërdrejta për bizneset që konkurrojnë në treg në formë të ndershme. Vlera monetare e këtyre përfitimeve nuk është përcaktuar për shkak të vështirësive, në parashikimin e nivelit të konkurrencës së pandershme.

Ndikime të tjera të mundshme përfshijnë:

- marrjen e disa roleve shtesë të Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me nevojat për garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese të inspektorateve shtetërore dhe vendore, në Republikën e Shqipërisë;
- krijimin e mundësive për një riorganizim të inspektorateve në bazë të fushave të lidhura me risqet e ngjashme, në bazë të metodologjisë së sugjeruar nga OECD dhe e zbatuar në disa shtete ku ka pasur reforma thelbësore në këtë fushë, si në Francë, Holandë, etj.
- mundësimin e mbikqyrjes së të gjithë sistemit të inspektimeve nga një Bord Inspektimesh, i përbërë nga përfaqësues politik të ministrive kryesore, i cili do të marrë vendimet kryesore strategjike dhe përcaktues të politikave të inspektimit, që përfshijnë miratimin e standardeve dhe metodologjive për shumë aspekte të fushës. Modelet e një Bordi të tillë janë përdorur në Holandë, Slloveni, Lituani si edhe janë pjesë e reformave të realizuara së fundi në këtë fushë në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, reforma këto të realizuara me mbështetjen e BERZH-it.
- uljen e numrit të inspektimeve në Operatorët e Biznesit, e cila sjell edhe uljen e barrës administrative, ulje të kostos në kohë/orë inspektimi pranë bizneseve (e pamatshme sepse përfshin strukturat që nuk kryejnë inspektim online), rritje cilësore e procedurës së inspektimit, rritje e konkurrueshmërisë dhe rregullim i klimës së biznesit;
- rregullimin e marrëdhënieve të punësimit dhe ngritja e sistemit të rekrutimit dhe karrierës nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit profesional sipas fushës së inspektimit;
- kryerjen e inspektimeve bazuar ne programe inspektive, si dhe vlerësim risku të përmirësuar për subjektin, i aplikuar për të gjitha fushat e inspektimi që e inspektojnë;
- vendosjen e një sistemi të qartë dhe efikas për trajtimin e ankesave dhe kontestimeve nga bizneset dhe individët në lidhje me veprimet inspektuese që operon pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, pa konflikt interesi, duke rritur kështu besimin për sistemin inspektues;
- uljen e kostove të pamatshme për procedimet administrative nga gjykata për masat administrative, të cilat bien poshtë për procedurë inspektimi, si dhe investimit të burimeve njerëzore të inspektorateve për ndjekjen e tyre, pasi komisioni i shqyrtimit të ankimeve në Inspektoratin e Përgjithshëm, mund të sigurojë pavarësi të trajtimit të rasteve dhe një nivel më të lartë të trajtimit procedural të inspektimit, duke reduktuar përcjelljen e çështjeve ne gjykatë.

Ndikimet sociale.

Ndikim social pozitiv jo të drejtpërdrejtë, i cili konsiston në rritjen e besimit tek qytetarët për funksionimin dhe zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin në nivel më të lartë të sigurisë dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve.

11. Propozimi pritet të çojë në një treg të formalizuar me konkurrencë të pastër, që do të thotë se do të kemi rritje të besimit dhe sigurisë të qytetarit, për produktet vendase.
12. Propozimi mund të shoqërohet me efekte sociale jo të drejtpërdrejta, përmirësime të mirëqenies personale të fituara përmes punësimit dhe ndikimet pozitive në komunitetin e gjerë nëpërmjet rritjes së punësimit.

Ndikimet mjedisore

13. Përmirësimi i cilësisë së inspektimeve në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me profesionalizmin e trupave inspektuese, seriozitetin dhe zbatimin e procedurave konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, do të sjellë ndikim indirekt edhe në cilësinë e mjedisit duke patur parasysh, që përmirësimi përfshin Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Autoritetin Kombëtar të Mjedisit, përgjegjës për çështjet e mjedisit si dhe inspektoratet e tjera, të cilat bashkëpunojnë me të, për të njëjtën çështje.
14. Riorganizimi i Inspektorateve, do të përmirësojë indirekt shkallën e ndotjes të ujërave, ajrit dhe tokës, do të përmirësojë dhe ruajë me përgjegjësi të lartë pyjet dhe kafshët e egra, do të ndikojë në mbrojtjen dhe sigurinë ushqimore të njerëzve, kafshëve etj.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit

Për të vlerësuar opsionet e marra në konsideratë do të përdoret gjithashtu edhe metoda e tretë e vlerësimit, e quajtur ndryshe edhe si ‘Analiza me shumë kriteret’. Kjo metodë lejon krahasimin e opsioneve në bazë të disa kriterëve të paravendosura. Në këtë rast do të përdorim pikërisht pjesën më të madhe të kriterëve të parashikuara në vetë Manualin e OECD-së për inspektimet⁶.

Ky manual ka shërbyer si dokument bazë për orientimin e ndryshimeve të projektligjit, duke përmbledhur rezultatet e shumëfishta që kërkohen të arrihen, pavarësisht se këto rezultate janë të vështira për t’u shprehur në terma monetarë.

Duke u bazuar në Metodologjinë e OECD-së për Inspektimet, janë përgjedhur 8 kriteret të cilat ndikojnë në sistemin e inspektimeve. Për këto kriteret janë përcaktuar peshat që në total janë 20. Në të njëjtën kohë, për secilin opsion bëhet një vlerësim nga 0 në 5, ku pesë është vlerësimi maksimal.

Kriteret janë si më poshtë:

1. *Fokusi në risk*

⁶ https://ëëë.oecd.org/en/publications/oecd-regulatory-enforcement-and-inspections-toolkit_9789264303959-en.html

Fokusi tek risku është një element shumë i rëndësishëm i inspektimit. Kjo realizohet nëpërmjet frekuencës së inspektimeve dhe burimet e përdorura, të cilat duhet të jenë proporcionale me nivelin e riskut. Inspektimet duhet të synojnë reduktimin e rrezikut real të shkaktuar nga shkeljet.

Vleësimi për opsionet:

Opsioni 0 – aktualisht vetëm dy inspektorate kanë bërë tentative për të përdorur sisteme të bazuar në risk. Bëhet një vlerësim minimal për këtë kriter.

Opsioni 1 dhe 2 – ligji i ri specifikon që planet mujore duhet të përcaktohen mbi bazë risku, në nivel subjekti. Për më tepër, Bordi i Inspektimit mund të vendosë objektiva për realizimin e këtij aspekti. Bëhet një vlerësim me vlerë 3, meqenëse kërkohen akte nënligjore dhe një mbështetje e konsiderueshme nga institucione ndërkombëtare që ky tregues të shkojnë në një nivel më të lartë.

2. Vizioni afatgjatë

Ligji duhet të ketë politika dhe mjete që përcaktojnë qëllime dhe objektiva afatgjatë. Kjo mund të realizohet nëpërmjet një kuadri institucional që shmang ndërhyrjet dhe politikat afatshkurtra.

Opsioni 0 – aktualisht nuk ka detyrime ligjore për të përcaktuar një vizion afatgjatë për inspektimin.

Opsioni 1 – nëse do të bëhej një ndryshim i paketë i ligjit ekzistues, atëherë nuk do të mundësonte një bazë të plotë për një vizion afatgjatë.

Opsioni 2 – vendosja në ligj e Bordit të Inspektimit mundëson përcaktimin e një vizioni për fushën e inspektimeve dhe një rezultat më të lartë.

3. Koordinimi dhe konsolidimi

Funksionet inspektuese duhet të koordinohen dhe aty ku është e mundur, të konsolidohen. Sa më pak dublikime dhe mbivendosje, aq më mirë përdoren burimet financiare dhe minimizohet barra e subjekteve.

Opsioni 0 – Inspektorati Qendror aktual ka bërë tentativa për të harmonizuar aspekte të vecanta, në ato raste kur ka pasur dublikime midis inspektorateve.

Opsioni 1 – ka më shumë mundësi për koordinim dhe konsolidim.

Opsioni 2 – ndryshimet ligjore mundësojnë shumë aspekte që lehtësojnë konsolidimin e inspektorateve të më pak inspektorate në bazë të fushave përkatëse dhe po ashtu Bordi i Inspektimit shërben si organ bashkërendues që mundëson një koordinim më të plotë në këtë fushë.

4. Transparenca

Inspektoratet duhet të mbështesin transparencën, profesionalizmit dhe menaxhimin e orientuar nga rezultatet. Zbatimi i politikave duhet të jenë i pavarur nga ndikimet politike dhe duhet të nxitet promovimi i përmbushjes vullnetare të ligjeve përkatëse.

Opsioni 0 – sistemi aktual ligjor ofron disa aspekte të transparencës

Opsioni 1 dhe 2 – shtohen aspektet e transparencës, të cilat kërkojnë një mbështetje më të mirë me akte nënligjore dhe mbështetje nga institucione ndërkombëtare.

5. Promovimi i përmbushjes së detyrimeve dhe proceset e drejta

Transparenca dhe promovimi i përmbushjes duhet të realizohet nëpërmjet mekanizmave specifikë, si guida, udhëzime, lista verifikimi dhe këshillime të vazhdueshme. Po ashtu të ofrohen sisteme të pavarura të ankimit.

Opsioni 0 – ka pak element të lehtësimit të përmbushjes.

Opsioni 1 dhe 2 – shtohen elementët ku përfshihen ato të këshillimit dhe procesi i ankimit i pavarur nga inspektorati përkatës.

6. Profesionalizmi i stafit

Inspektorët duhet të trajnohen dhe të menaxhohen për të siguruar profesionalizëm, integritet, qëndrueshmëri dhe transparencë: kjo kërkon trajnim cilësor që fokusohet jo vetëm në aftësitë teknike, por edhe në aftësitë e përgjithshme të inspektimit.

Opsioni 0 – ligji ekzistues jep hapësirë për një sistem trajnimesh

Opsioni 1 – përmirësimi i ligjit ekzistues jep mundësi për të mirësuar profesionalizmin, por jo aq sa duhet.

Opsioni 2 – ligji i ri jep hapësira për të trajtuar në mënyrë të plotë shumë aspekte të profesionalizmit të stafit të inspektorëve.

7. Sistemet informative

Opsioni 0 – ligji ekzistues krijon bazat për një sistem elektronik inspektimi.

Opsioni 1 dhe 2 – projektligji përmban aspekte më të plota për të përmirësuar ndërveprimin e sistemeve të inspektimit.

8. Kosto-efektiviteti

Kostot e përgjithshme të sistemit nuk do të ndryshojnë në mënyrë thelbësore, por efektiviteti do të rritet për shkak se opsioni 2 ofron një zgjidhje më efikase gjatë zbatimit të legjislacionit në të ardhmen. Nga ana tjetër, përmirësimi i kostove të biznesit do të sjellë ulje të barrës së përmbushjes së detyrimeve ligjore në të gjithë fushat e inspektimit.

Opsioni 2 – vlerësohet me rezultatin më të lartë.

		Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2
1	Fokusi tek risku	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)
2	Vizion afatgjatë	1	0 (0)	2 (2)	4 (4)
3	Koordinimi dhe konsolidimi	3	2 (6)	3 (9)	4 (12)
4	Transparencë	1	1 (1)	2 (2)	2 (2)
5	Promovimi i përmbushjes dhe procese të drejta	1	1 (1)	3 (3)	3 (3)
6	Profesionalizmi i stafit	4	1 (4)	2 (8)	4 (16)
7	Sistemet informative	3	2 (6)	3 (9)	3 (9)
8	Kosto-efektiviteti	4	2 (8)	3 (12)	4 (16)
	Total		29	54	67

Në bazë të rezultateve të peshuara zgjidhet opsioni i dytë. Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni i dytë (projektligji i ri për inspektimet) vlerësohet me më shumë pikë dhe sugjerohet të zgjidhet si opsioni kryesor i preferuar.

Opsioni 2, i preferuar, për krijimin e një Inspektorati të Përgjithshëm të pavarur, që garanton zbatimin e ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet Ndërkombëtare si dhe garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë inspektuese të inspektorateve të riorganizuara në 7 (shtatë) Inspektorate Shtetërore.

Opsioni i preferuar do të mundësojë:

- a) **numër i inspektorëve nuk ndryshon;**
- b) do të ushtrohet veprimtari inspektuese më efektive dhe cilësore, të programuara **bazuar në vlerësimin e riskut për të gjitha fushat;**
- c) do të ketë një ulje deri në 36% të numrit të inspektimeve, nga 110 mijë që janë aktualisht në rreth 70 mijë;
- d) **do t'i ofrohet biznesit një qasje me transparente në lidhje me format e inspektimit, si dhe institucionet përgjegjëse inspektuese;**
- e) do të garantojë **komunikim nëpërmjet një burimi qendror**, i cili maksimizon dhe përshpejton fokusin në risqe, nxit bashkërendimin dhe ndarjen e informacionit në kohë reale duke garantuar reagim të shpejt dhe efektiv;
- f) do të sigurohet, **rritje cilësore e kapaciteteve kontribuese institucionale**, si dhe e integritetit të trupave inspektuese nëpërmjet një procesi rekrutimi të standardizuar bazuar në sistemin e karrierës nëpërmjet klasifikimit me nivele të inspektorit;
- g) do të shtohet numri i punonjësve të Inspektoratit të Përgjithshëm, me 60 punonjës, të cilët do të lëvizin nga stukturat mbështetës në inspektorate, drejtori/agjenci;
- h) do të krijohen struktura në Inspektoratin e Përgjithshëm, të cilët do të mbulojnë funksionet e parashikuara në ligjin e ri për inspektimin që përfshijnë mbështetjen teknike të funksionimit të bordit të inspektimeve, trajnimin dhe testimin e inspektorëve, mbështetjen teknike të komisioneve të vlerësimit, rekrutimit dhe disiplinës, komisionit të shqyrtimit të ankimimit administrativ, si dhe ofrimit të këshillimit të publikut;
- i) do të sjellë **ulje të riskut** në sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemet e pagesave, sistemet e prokurimeve, sistemet e kontabilitetit dhe raportimit financiar, si dhe sistemet e programimit dhe zbatimit të buxhetit;
- j) do të garantohet pranë Inspektoratit të Përgjithshëm **proces transparent për shqyrtimin e ankimimeve dhe pritjet e këtyre me pak kontestueshmëri në gjykatë** për masat administrative të marra nga trupat inspektuese;
- k) do të rregullojë marrëdhëniet e punësimit të inspektorit dhe të sigurojë ndërtimin e sistemit të rekrutimit, karrierës dhe profesionalizmit nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes në nivel, sipas fushës së inspektimit;

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar do të jenë, të gjitha ministritë e linjës, të cilat kanë në varësi struktura si Inspektoratet Shtetërore dhe agjencitë/drejtoritë, të cilat kryejnë veprimtari inspektuese.

Pengesat e mundshme për realizimin e zbatimit të opsionit të përzgjedhur kanë të bëjnë me:

- kohën që do të duhet për ndryshimet në aktet ligjore dhe më pas ato nënligjore për strukturat inspektuese shtetërore ekzistuese si dhe ato të reja (drejtori/agjenci me funksione inspektuese);
- përgatitjen e listave të verifikimit për strukturat e reja që do të përfshihen si pjesë e inspektoratit shtetëror si dhe trajnimi i tyre për realizimin e procedurave të inspektimit me dokumente standarde, nëpërmjet sistemit të digjitalizuar;
- përgatitjen e moduleve të reja të sistemit për realizimin e veprimtarive inspektuese të 8 Inspektorateve Qendrore të riorganizuara me fusha të ndryshme inspektimi dhe veprimtarie (listat e verifikimit dhe dokumentet standarde të inspektimit);
- përgatitjen e kriterëve për emërimin e inspektorëve për secilin pozicion referuar niveleve të përcaktuara në ligjin për inspektimin;
- në bashkëpunim me AKSHI:
 - përmirësimin e softeve të sistemit “e-Inspektimi”, për të përballuar ngarkesën me informacion dhe të dhëna për një procedurë inspektimi.
 - Garantimin e pajisjeve elektronike të inspektorëve si: tabletë për kryerjen e inspektimit online, desktop, laptop, kompletimi me pajisje elektronike të sallës së monitorimit të trupave të inspektimit, gjatë kryerjes së procedurave në terren.
 - Bashkëveprimin e sistemeve në funksion të veprimtarive inspektuese, si dhe këshillimit publik, sipas miratimit të Inspektorit të përgjithshëm

Aktet nënligjore (vendime të Këshillit të Ministrave) që parashikohen të miratohen për zbatim:

“Për përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Bordit të Inspektimeve”

“Për përcaktimin e procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, lirim dhe shkarkimin e Inspektorit të Përgjithshëm”

“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, si dhe procedurat për shkarkimin dhe lirim nga detyra të kryeinspektorit të inspektoratit qendror”;

“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Rekrutimit dhe Ecurisë në Karrierë”

“Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për programimin e inspektimeve dhe metodologjinë e vlerësimit të riskut”;

“Për përcaktimin e periudhës maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore”;

“Për miratimin e rregullores së përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit”;

“Për përcaktimin e procedurave të hollësishme për marrjen, trajtimin e mostrave dhe për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive sipas tipit të inspektimit, si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve”;

“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit”

Parashikohet që Inspektorati i Përgjithshëm të ketë rezultat në përmirësimin cilësor të veprimtarisë inspektuese, duke arritur konkretisht:

- Përfshirjen e veprimtarive inspektuese për të gjitha strukturat e reja në rrjetin e shërbimeve publike të modernizuara, nëpërmjet infrastrukturës digjitale me dokumente standarde, listë verifikimi, dhe inspektime të programuara me vlerësim risku.

- Garantimin e pavarësisë funksionale të inspektorateve me efektin e ndarjes së politikë-bërjes nga procesi i inspektimit.
- Menaxhimin dhe koordinimin më të mirë të Inspektorateve Qendrore, duke qenë se riorganizohen nga 16 në 8 inspektorate, përfshirë edhe strukturat e tjera inspektuese agjencitë/drejtoritë.
- Krijimin e një numri inspektorësh në inspektorate i cili justifikon punën e bërë.
- Reduktimin e numrit të inspektimeve në Operatorët e Biznesit (prej dublikimeve si dhe prej disa fushave të inspektimit).
- Uljen e barrës administrative ndaj subjektit, si dhe kostos në kohë/orë inspektimi në subjekt.
- Uljen e numrit të ankimimeve të subjekteve që i drejtohen gjykatës për shqyrtim të procedurave të inspektimit me masë administrative.
- Mbarëvajtje gjatë ushtrimit të kompetencave midis inspektimeve në nivel qendror/lokal.
- Evitimin e dublikimeve dhe mbivendosjeve të kërkesave ligjore të inspektimit nga inspektorate me veprimtari inspektuese të fushave të ndryshme.
- Ushtrimin e kompetencave ligjore institucionale pa konflikt interesi, për Inspektoratet Qendrore.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i politikës që propozohet, do të realizohet nga Bordi i Inspektimeve, Inspektorati i Përgjithshëm si dhe 8 Inspektoratet Qendrore të propozuara.

Inspektorati i Përgjithshëm, do të sigurojë funksionimin e një sistemi koherent të monitorimit dhe raportimit, pasi 8 Inspektoratet Qendrore duhet të shfrytëzojnë të njëjtin sistem të monitorimit dhe raportimit, për sa i përket formave (modeleve) dhe afateve. Inspektoratet do të raportojnë për veprimtarinë inspektuese tek Ministri përgjegjës dhe Inspektori i Përgjithshëm Shtetëror.

Hapat, afatet dhe modelet e raportimit do të përcaktohen në udhëzime për monitorimin dhe raportimin, të cilat do të përgatiten nga Inspektorati i Përgjithshëm Shtetëror.

Inspektorati i Përgjithshëm Shtetëror do të raportojë për veprimtarinë inspektuese në Republikën e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave.

Monitorimi i Inspektorateve do të jetë një proces i vazhdueshëm i grumbullimit sistematik të të dhënave, në pajtim me indikatorët e caktuar, me qëllim vëzhgimin e shkallës së progresit dhe të realizimit të objektivave dhe politikave të vendosura.

Inspektoratit të Përgjithshëm, si strukturë me funksion rregullator do të jetë përgjegjës për garantimin e ligjshmërisë në çështjet e inspektimit, rekrutimit, sistemit të karrierës dhe veprimtarisë laboratorike.

Monitorimi do të kryhet, duke u bazuar tek të dhënat e inspektimeve online dhe rezultatet e inspektimeve të realizuara sipas vlerësimit të riskut, masave administrative të marra, referuar ankimimeve të operatorëve të biznesit, në lidhje me procedurat e inspektimit si dhe ankesat e inspektorëve dhe qytetarëve.

Tregues do të jetë edhe fryma që do të përcjellin bizneset për ofrimin e një qasjeje më transparente të veprimtarive inspektuese, duke filluar nga ofrimi informacionit të nevojshëm për bizneset e reja, cilësia e inspektimeve, thjeshtësia në aplikimet dhe përcjelljen e dokumentacionit të inspektimit në kohë reale, mungesa e inspektimeve të shpeshta. Kjo e dhënë do të vijë nga aktorët e interesit, që janë dhomat e tregtisë dhe industrisë vendase dhe të huaja, si dhe Këshilli Ekonomik Kombëtar.

Tregues tjetër do të jetë dhe numri i ankimimeve të qytetarit, i cili identifikon rastet e ushtrimit të veprimtarisë inspektuese nga ana e trupës inspektuese, në shkelje të ligjit.

Sa më i ulët të jetë numri i treguesve të problematikave të hasura, aq më i madh dhe i suksesshëm do të jetë treguesi i progresit të këtij modeli të riorganizimit të Inspektorateve.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Vlerësimi bazë mund të bëhet në kostot e biznesit, duke llogaritur që 40 mijë inspektime më pak, me një kosto prej 4000 lekë për inspektim, sjellin një efekt prej 160,000,000 lekë në vit.

	Viti 1 2024	Viti 2 2025	Viti 3 2026	Viti 4 2027	Viti 5 2028	Viti 6 2029	Viti 7 2030	Viti 8 2031	Viti 9 2032	Viti 10 2033
Faktori zbritës		0.95	0.89	0.84	0.78	0.72	0.66	0.6	0.52	0.45
Kosto për buxhetin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim (shpnz.operative,kapital, adminis)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera –	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

në vazhdim										
Kosto në total	-	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim		160	160	160	160	160	160	160	160	160
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total		160	160	160	160	160	160	160	160	160
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës		152	142	134	125	115	105	90	72	67
Vlera aktuale e kostos në total	-									
Vlera aktuale e përfitimit në total	1,520									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	1,520									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	-	1,520	1,520